

PROCESVERBAL 21/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 3 (tretë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitetet, mbajtur me datë 21.03.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirimin nga taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje për gratë dhe ndërtimet në bashkëpronësi të burrit dhe gruas;
5. Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që është një kërkesë nga ekzekutivi ku kërkojnë nga asambleja komunale të jepet pëlqimi për të zhvilluar procedurat për dhënie në shfrytëzim afatgjatë 15- 99 vite pronën e paluajtshme të komunës në vendin e quajtur “Pojata” me sipërfaqe 2943 m².

Kryesuesi - e hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Avni Bytyqi - kjo pikë ka të bëjë me formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqura ofertuese pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhur nga ana e

komisionit. Ky komision përbëhet prej 5 anëtarëve ku 2 do të jenë nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 përfaqësues nga sektori jo qeveritar.

Kryesuesi - e hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirimin nga taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje për gratë dhe ndërtimet në bashkëpronësi të burrit dhe gruas;

Avni Bytyqi - kjo kërkesë ka ardhë nga grupi i grave të kuvendit me qëllim të fuqizimit të gruas në pronë ku është propozuar që të lirohen nga taksa për legalizim të objektit në pronësi të burrit dhe gruas dhe në pronësi vetëm të grave. Kjo vlen për të gjithë pa dallim feje, race, gjinie. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim.

Aprovohet pika 4

Pika 5. Të ndryshme;

Kryesuesi - unë sot kam pas të raportojë sa i përket shkollës në Gelancë lidhur me mungesën e nxënësve sa i përket komunitetit ashkali atje. Besoj javën e ardhshme do ta bëj një vizitë dhe do të marr raport mbi gjendjen aktuale në atë shkollë. Te çështja e riatdhesimeve, si është gjendja dhe ata që janë riatdhesu a ka pas mbështetje në programet të cilat janë në programet në kuadër të zyrës tuaj?

Xeladin Sadikaj - data baza është dhe kemi afatin kohor 15 ditë me iu përgjigj.

Kryesuesi - kam pas disa telefonata se ku duhet të adresohen.

Xheladin Sadikaj - ata janë të udhëzuar, qysh në aeroport është zyra aty. Duhet të plotësohet data baza në komunë. ZKK tutje jep sqarime.

Kryesuesi - do të thotë raste kemi që janë duke u kthyer dhe janë duke përfutur.

Xheladin Sadikaj - të komunitetit e kemi një këtë muaj.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor i informon të pranishmit se në komunën e Suharekës është duke u zbatu rregullorja për të riatdhesuarit për arsye se komuna jonë e ka të themeluar edhe mekanizmin për të riatdhesuarit. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Takimi përfundoi: 09:15